

RAPORT FINAL ANGAZHIMI

I. HYRJE

Mbështetur në ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Manualin e Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, në zbatim të programit të angazhimit nr.1014/1 prot, datë 19/11/2018 të miratuar nga Drejtori Ekzekutiv në Drejtorinë e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave (ndryshuar emërtim me VKM nr.28, datë 23.1.2019 në Drejtoria Ekonomike) u krye auditim “ **Mbi funksionimin dhe realizimin e detyrave të programuara, bashkëveprimi i punës me sektorët në varësi, problemet e hasura dhe të zgjidhura nga sektorët për këtë periudhë, analiza e punës për objektivat e realizuar dhe detyrat në të ardhmen**” të miratuar nga Titullari.

Auditimi u krye në zbatim të Ligjit Nr.114 datë 22.10.2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Manualit të Auditimit të Brendshëm 2016, Kodit Etik për Auditët e Brendshëm dhe të Kartës së Auditimit të Brendshëm Publik, nga grupi i Auditimit z.Thoma Papadimitri Përgjegjës grupi dhe znj.Shkurte Halili anëtar për periudhën Dhjetor 2018 deri më 29.03.2019. Ky auditim u ndërpre me Urdhër të Drejtorit Ekzekutiv Nr.1014/2 prot, datë 03.12.2018 “Për shtyrjen e afatit të misionit të auditimit në Drejtorinë e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave”.

Për kryerjen e auditimit financiar dhe përputhshmërisë , mbi detyrat e objektivat e programuar dhe të realizuar, si kanë funksionuar e si ka qenë bashkëveprimi i punës me sektorët në varësi, me drejtoritë, me sektorët e zyrat pritëse, si janë zbatuar akt-marrëveshjet e lidhura me institucionet e tjera, legjislacioni në fuqi, respektimit të rregullores së brendshme, kodit të etikës të institucionit për periudhën 01.01.2016 deri më 30.04. 2018, u përdor metodologjia e auditimit të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje (ec përmes e vijues sipas MAB) , teste me zgjedhje të rastësishme, metoda e kontrollit aritmetik, kontrole me anë të dokumentave justifikuese, kontrolli i vlerësimit, raporte dhe informacione të ndryshme.

Në përfundim të punës në terren me datë 01.04.2019, u krye takimi përmbyllës në subjektin e audituar ku u diskutuan konkluzionet e auditimit, të cilat janë trajtuar gjerësisht në Projekt Raportin e Angazhimit.

Projekt Raporti i Angazhimit u mbajt në përfundim të misionit të angazhimit, mbi bazën e gjetjeve të konstatuara dhe rekomandimeve të dhëna sipas natyrës së gjetjeve i cili u dorëzua në sekretari më shkresën nr.1014/3, datë 05.04.2019.

Nga nëpunësi përgjegjës me shkresën nr.1014/4, datë 09.04.2019 u paraqit observacion lidhur me gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit. Këto observacione pasi u shqyrtuan nga grupi i auditimit janë kryer rregullimet dhe sqarimet përkatëse dhe në përfundim u përgatit ky Raport Final Angazhimi.

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

Veprimtaria e Drejtorisë së Financës dhe Administrimit të të Ardhurave është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të ligjit nr.9228, datë 20.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare,” i ndryshuar, Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik” i ndryshuar, Ligjin nr.10269, datë 08.07.2011 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit nr.13, datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte në zbatimin e buxhetit”, Aktit normative të K.M nr.1, datë 29.07.2016 “Për disa ndryshime në ligjin nr.147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, VKM nr.997, datë 10.12.2016 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e kësaj Drejtorie.

Nga misioni i auditimit të realizuar në Drejtorinë e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave (Drejtoria Ekonomike) u konstatuan disa gjetje për të cilat janë lënë dhe rekomandime për përmirësimin e punës në të ardhmen.

Gjetjet kyçe të auditimit.

Gjetje nr.1

Në verifikimin e kryer për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit të zhvilluar në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve rezultoi se nga 18 rekomandime të lëna, 17 prej tyre janë realizuar dhe 1 rekomandime nuk ka gjetur zbatim, në shkelje të kërkesave të Ligjit nr.114/2015, neni 12, pika d, si dhe Shkresës së Drejtorit Ekzekutiv nr. 790/4 prot, datë 13/ 11 /2017 “*Dërgojmë Raportin Final të Angazhimit të Auditimit*”.

Gjetje nr.2

Nga Sektori i Marketingut dhe Komunikimit si dhe mirëmbajtësi i godinave janë tërhequr nga magazina mallra e materiale për promovimin e ADISA në aktivitete të ndryshme, si dhe për riparimin e defekteve të ndodhura në zyrat ADISA dhe Zyrat Pritëse nëpër rrethe, por fletë daljet nuk kanë të bashkëngjitur dokumenta justifikues se ku u përdorën këto mallra dhe materiale si në rastin e Fl.d nr.65, dt.28.03.2017 tërhequr 30 USB me 8 GB me vlerë 12.3018 lekë, Fl.d nr.133, datë 05.09.2017 tërhequr mallra dhe materiale inventari me vlerë 2,778,400 lekë, Fl.d nr.216 dt.06.12.2017 tërhequr materiale promovimi me vlerë 443.984 lekë.

- Drejtoria e Administrimit të Brendshëm (Sektori i Shërbimeve Mbështetëse) nuk ka ushtruar kontrollin e duhur dhe nuk ka evidentuar mangësitë në kërkesat e kryera nga punonjësit e ADISA, kjo referuar kryesisht mallrave dhe materialeve të tërhequra nga Sektori i Marketingut (i cili ka tërhequr nga magazina jo vetëm materialet që i nevojiten për realizimin e objektivave, por ka tërhequr dhe uniformat e punonjësve të Zyrave Pritëse ADISA) të cilat nuk i ka administruar siç duhet pasi nuk ka të evidentuar se ku janë përdorur

këto materiale, sa nga këto materiale janë përdorur dhe sa prej tyre janë kthyer në magazinë (një pjesë e tyre aktualisht janë gjendje në magazinë).

- Magazinieri nuk ka evidentuar me dokumenta se cilat materiale janë kthyer në magazinë dhe sa janë në ruajtje, të gjitha këto veprime bien në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 ‘Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik’.

Gjetje nr.3

Në përfundim të inventarizimit të kryer në ADISA, Komisioni i inventarizimit ka evidentuar disa materiale për jashtë përdorimit në vlerën prej 26,306.56 lekë dhe me Memon nr.1186/1 dt.10.01.2017 me subjekt “Mbi inventarizimin e aktiveve afatgjata materiale e jomateriale dhe afatshkurtra” ka informuar Nëpunësin Autorizues dhe Nëpunësin Zbatues. Nga auditimi i dosjes së inventarit të vitit 2017 nuk rezultoi se nga Nëpunësi Autorizues është nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e matrialeve të propozuara dhe nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit në kundërshtim me Udhëzimin nr.30 dt.27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar “Proçesi i Vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi”.

Gjetje nr.4

Me ndryshimin e Strukturës së Këshillit të Ministrave në muajin Shtator 2017, Urdhëri Nr.1, datë 19.01.2016 i Ministër Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për delegim kompetencash” nuk ka fuqi ligjore. Urdhërat e Brendshëm të dalë për nisjen me shërbim të punonjësve, nuk janë firmosur nga nëpunësi përgjegjës sipas VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”,i ndryshuar,Kreu V “Dërgimi me shërbim i punonjësit” pika 2,gërma ii.

Gjetje nr.5

Autoriteti Kontraktor në proçedurën e prokurimit “Blerje Tонера”, “Shtesë kontrate Blerje Tонера për nevoja të fillim vitit 2017”, fondi limit 494,273.52 lekë pa tvsh, ka lidhur shtesë kontrate pasi ka kaluar afati i përcaktuar, në VKM nr.914 dt.29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,neni 2,pika 3 gërma a,b,dhe pika 7,neni 36,gërma d.

Gjetje nr.6

Spektori i Financës në momentin e pagesës së faturës për proçedurën e prokurimit “Blerje materiale pastrimi”, fondi limit 2,655,630 lekë pa tvsh, nuk ka llogaritur dhe ndalur vlerën e garancisë së kontratës prej 260.034 lekë, në kundërshtim me nenin 17 të saj.

Gjetje nr.7

- Afati i lëvrimit të mallit për procedurën e prokurimit “Blerje kanceleri”, fondi limit 41,624,357.40 lekë pa tvsh sipas nenit 6 të kontratës është tejkaluar me rreth 93 ditë, në kundërshtim me kushtet e kontratës, neni 6.

- Sektori i Financës ka kryer likuidimin e faturës pa llogaritur dhe mbajtur penalitet sipas nenit 11 “sanksionet”. (vlera e penalitetit e llogaritur për 93 ditë vonesë është: $(93 \text{ ditë} \times 1.416.579 \times 4/1000 = 526.967 \text{ lekë})$).

Gjetje nr.8

Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit “Rikonstruksioni i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike, Gjirokastër- ADISA” Fondi limit: 50.555.093 lekë pa tvsh, në të dy rastet (emërimit dhe zëvendësimit) është përcaktuar në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar neni 58 i tij “komisioni i vlerësimit të ofertave” pasi Kryetari i KVO duhet të jetë Zyrtarë i Lartë Drejtues i Autoritetit Kontraktor, po kështu në rastin e ndryshimit të Kryetarit të komisionit nuk janë respektuar procedurat ligjore.

Gjetje nr.9

- Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për procedurën e prokurimit “Rikonstruksion i Qendres per Ofrimin e Sherbimeve Publike te Integruara Krujë” Fondi limit: 18.244.093,33 leke pa tvsh, është caktuar një punonjës jashtë ADISA-s i marrë me kontratë të përkohshme, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, neni 58 “Komisioni i vlerësimit te ofertave”, paragrafi i dytë.

- Nuk ka proces -verbal nga kontraktuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve se kur kanë filluar punimet shtesë në kundërshtim me kushtet e kontratës neni 14 -Ekzekutimi i punimeve-, pika 14.2.

Gjetje nr.10

- Zëvendësimi i Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në Procedurën e prokurimit :Shërbimi i ruajtjes dhe Sigurisë Fizike Zyra Pritëse Tiranë dhe godina ADISA”, Fondi limit: 3,907,070 lekë pa tvsh, është kryer pa dhënë asnjë arsye.

- Emërimi i kryetarit të ri të KVO është bërë në kundërshtim me kriteret ligjore, pasi punonjësi i emëruar si kryetar është i punësuar si specialist dhe jo Drejtues i Lartë i Autoritetit Kontraktor në kundërshtim me VKM nr.914 dt.29.12.2014 i ndryshuar, nenit 58 – Komisioni i vlerësimit të ofertave.

III. METODA E AUDITIMIT.

Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë mbi detyrat e objektivat e programuara dhe të realizuara, si kanë funksionuar e si ka qenë bashkëveprimi i punës me sektorët në varësi, me drejtoritë, me sektorët e Zyrat Pritëse, si janë zbatuar aktmarrëveshjet e lidhura me institucionet e tjera, legjislacioni në fuqi, respektimit të rregullores së brendshme, kodit të etikës së institucionit u përdor metoda: Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje (ec përmes e vijues sipas MAB) , teste me zgjedhje të rastësishme, metoda e kontrollit aritmetik, kontrole me anë të dokumentave justifikuese, kontrolli i vlerësimit, raporte dhe informacione të ndryshme, pas vlerësimit të riskut të mesëm të mjedisit të kontrollit që u krye në dokumentimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Auditimi përfshin periudhën nga 01.01.2016 deri më 30.04. 2018.

Auditimi u krye gjatë periudhës 20 Nëntor 2018 deri më 15 Dhjetor 2018 nga grupi i auditimit z.Thoma Papadhimitri Përgjegjës grupi dhe znj.Shkurte Halili anëtar, ky auditim u shty me Urdhër të Drejtorit Ekzekutiv Nr.1014/2 prot, datë 03.12.2018 “Për shtyrjen e afatit të misionit të auditimit në Drejtorinë e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave” deri më 29.03.2019.

Qëllimi dhe misioni i këtij auditimi është shqyrtimi, vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e tyre duke përdorur burimet financiare e njerëzore në mënyrë ekonomike dhe efçente, për arritjen e objektivave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për periudhën objekt auditimi.

IV. GJETJET DHE KONKLuzionET SIPAS PIKAVE TË PROGRAMIT:

1. Sistemi i kontrollit të brendshëm.

1.1 Ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Drejtoria e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave nuk është audituar ndonjëherë si drejtori por janë audituar sektorët e kesaj drejtorie kështu Sektori i Financës është audituar në bazë të Programit të Angazhimit nr.790/1 prot, datë 31.07.2017 “*Mbi hartimin e planifikimin e programit ekonomik për periudhën Janar 2016 - Qershor 2017, ndjekja e realizimit të tij, realizimi i shpenzimeve sipas zërave në programin ekonomik, pasqyrimi i drejtë i tyre në kontabilitet, mbajtja e azhurnimi i kontabilitetit sipa llogarive e nënlllogarive, problemet që kanë dalë në këtë drejtim, përputhja e dokumentacionit justifikues dhe pasqyrimi i saktë në bilancin e fund vitit*”, për periudhën 01.01.2016 deri më 30.06.2017, Sektori i Prokurimeve është audituar në bazë të Programit të Angazhimit nr.534/1 prot, datë 19.05.2017 “*Mbi hartimin e planifikimin e nevojave për kryerjen e shpenzimeve për blerje me vlera të vogla, pasqyrimi i tyre në programin e buxhetit vjetorë, zbatimi i ligjshmërisë në kryerjen e blerjeve të vogla*” për periudhën 01.01.2016 – 31.12.2016.

Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në këto angazhime auditimi, nga Përgjegjësi i Sektorit të Auditit është dërguar një E-mail drejtorëve të Drejtorisë për rikujtesë për zbatimin e rekomandimeve sipas drejtorive. Nga Drejtoria e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave me e-mail datë 18.01.2018 dhe e-mail datë 22.01.2018 janë dërguar shkresa për zbatimin e rekomandimeve nga Sektori i Financës dhe Sektori i Prokurimeve.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve nga këta sektor gjatë këtij angazhimi u konstatua se rekomandimet e lëna në auditimin e fundit të zhvilluar në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve janë marrë në shqyrtim dhe 17 prej tyre janë realizuar, 1 rekomandime nuk është realizuar. Rekomandimi i pa zbatuara është:

Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin e Prokurimit të kërkojë arkëtimin e shumës nga subjekti fitues Denis Mana për pagesën paguar më tepër sipas U.Sh nr.66 dt.30.11.2016 në shumën prej 7200 lekë, në të kundërt të kryhet arkëtimi nga personat përgjegjës.

U rekomandua që titullari i institucionit të nxjerrë urdhër të brendshëm dhe të marrë masa për ndjekjen e zbatimit të rekomandimit të lënë në auditimin e kaluar dhe që nuk ka gjetur zbatim. Në rast të mosarkëtimit të shumës prej 7.200 lekë, paguar më tepër subjektit fitues Denis Mana sipas urdhër prokurimit nr.66 dt.30.11.2016, të fillojë zhdëmtimi nga punonjësit përgjegjës. (Rëndësia/Risk i mesëm).

Nëpunësi përgjegjës me shkresën nr.1014/4 prot, datë 09.04.2019 është shprehur dakort me gjetjen dhe rekomandimin e lënë kështu që gjetja do të pasqyrohet dhe në Raportin Final të Angazhimit.

2- Mbi funksionimin në tërësi të kësaj drejtorie, realizimi i objektivave të programuar, zbatimin e legjislacionit në fuqi, realizimi i programit ekonomik i shpenzimeve material, paga, blerje e shpenzime për investime etj, bashkëveprimi i punëve me drejtoritë e zyrat pritëse dhe objektivat në të ardhmen (për auditimin e prokurimeve periudha do të jetë Janar 2016 – Prill 2018) në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Funksionimi i Drejtorisë së Financës dhe Administrimit të të Ardhurave në realizimin e detyrave dhe objektivave të saj (funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit).

Veprimtaria e i Drejtorisë së Financës dhe Administrimit të të Ardhurave është fokusuar në aspektet financiare/ekonomike të Institucionit, duke u ndalur në pikat si më poshtë:

1. Menaxhimi i fondeve të Buxhetit të Shtetit;
2. Ndjekja dhe zbatimi i procedurave ligjore për prokurimin publik të mallrave, punëve dhe shërbimeve duke marrë për bazë të gjitha kërkesat dhe nevojat që ka Institucioni, me qëllim plotësimin në kohë të tyre;
3. Ndjekja e procedurave të nevojshme për mundësinë e gjenerimit të të ardhurave nga burime të tjera financimi, për projekte të iniciuara nga Drejtoritë politik bërëse të Institucionit, duke i prezantuar tek donatorë potencialë të mundshëm.

Nga auditimi rezultoi se kjo Drejtori ka funksionuar dhe funksionon mbi bazën e Rregullores së Brendëshme miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.2, datë 03.10.2016 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës së Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

- Në vitin 2014, struktura është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.266, datë 16.12.2014, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara", e ndërtuar me 3 drejtori (ku një nga këto drejtori është Drejtoria Operacionale pjesë përbërëse e së cilës është dhe Sektori i Financës).

Me VKM nr.103, datë 16.07.2015 është miratuar struktura e re ku Sektori i Financës dhe Sektori i Prokurimeve janë pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe Godinave

Me VKM Nr.654, datë 14.09.2016 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Ofrimit të shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)” kjo drejtori është emëruar si Drejtoria e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave e përbërë nga 3 sektorë, Sektori i Financës, Sektori i Prokurimeve, Sektori i Administrimit të të Ardhurave dhe Menaxhimit të Projekteve duke bërë që numri i punonjësve gjithsej në këtë drejtori të jetë 11 punonjës gjithsej, me VKM nr.306, datë 05.04.2017 “Për ndryshime në VKM Nr.654, datë 14.09.2016 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Ofrimit të shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), numri i punonjësve në këtë drejtori është miratuar me 13 punonjës, në përfundim të auditimit rezultoi se kjo drejtori ka tre vende vakante.

Nga auditimi rezultoi se stafi i kësaj drejtorie për periudhën objekt auditimi ka përgatitur Planin Vjetor të Punës në realizim të objektivave të vendosur.

Për vitin 2017 dhe 2018 kjo drejtori ka hartuar planin vjetor të zbërthyer në objektiva specifik dhe plane veprimi konkret me afate kohore për realizimin e tyre. Stafi i drejtorisë ka bashkërenduar punën në vazhdimësi dhe raportuar në mënyrë periodike, mbi punën e kryer dhe aktivitetet e saj.

Konkluzion

Struktura aktuale e Drejtorisë së Financës dhe Administrimit të të Ardhurave, është organizuar në përputhje me strukturën organizative dhe organikën e përcaktuar dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.2, datë 03.10.2016 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës së ADISA”. Kjo strukturë i përshtatet karakterit të aktivitetit të saj dhe është në gjendje ti japë informacionin e nevojshëm titullarit për marrjen e vendimeve të menaxhimit.

Organizimin e kontrollit të brendshëm në Drejtorinë e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave.

Vlerësimi i efektivitetit të komponentëve të kontrollit të brendshëm bëhet në drejtim të hartimit të kontrolleve të brendshme, implementimit të tyre dhe në fund funksionimit. Për sa më sipër,

komponentët e kontrollit të brendshëm në Drejtorinë e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave rezultojnë si më poshtë:

1. Mjedisi i kontrollit

a)Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj drejtorie.

Drejtoria e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave ka funksionuar mbi bazën e Rregullores së Brendshme miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.2, datë 03.10.2016 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës së Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)”, përpara kësaj rregulloreje institucioni nuk ka patur rregullore të miratuar. Lidhur me respektimin e etikës, institucioni nuk ka të miratuar veçmas një kod të tillë sikur kërkohet në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni.20, pika (2), gërma (a), sa më sipër është e përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit ADISA, punonjësit duhet të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjellët.

b) Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Për periudhën Shtator 2016 deri në momentin e auditimit drejtoria ka funksionuar dhe është organizuar mbi bazën e strukturës së miratuar me VKM Nr.654, datë 14.09.2016 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Ofrimit të shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)” ku kjo drejtori është organizuar në 3 sektorë dhe numri i punonjësve është 11, me VKM nr.306,datë 05.04.2017 është miratuar numri i punonjësve të kësaj drejtorie me 13 punonjës.Gjatë auditimit konstatohet se numri faktik i punonjësve të kësaj drejtorie është 10 nga 13 punonjës të miratuar, pra konstatohet **3 vende vakante**.

Nga drejtuesi i Drejtorisë, është siguruar mbikëqyrja e monitorimi i punës për secilin punonjës, në mënyrë që të sigurohet si duhet integriteti personal dhe etika profesionale, duke përjashtuar konfliktin e interesit në kryerjen e detyrave funksionale, në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” ndryshuar me ligjin nr.110, datë 15/10/2015 në lidhje me “*ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin,miratimin,zbatimin,kontabilitetin dhe kontrollin*”.

c.Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;

Procedurat e rekrutimi të stafit në ADISA dhe në veçanti për Drejtorinë e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave janë kryer bazuar në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë dhe kriteret e miratuara me vendim nr.2, datë 03.10.2026 të Këshilli Drejtues ADISA.

d.Përshkrimet e proceseve të punës.

Pozicionet e punës për secilin punonjës të kësaj drejtorie nuk kanë ndonjë kërkesë specifike të përcaktuar në aktet ligjore në fuqi. Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk janë kryer përshkrimet e proceseve të punës në përputhje me punën që kryen secili pozicion, duke përfshirë dhe objektivat, qëllimi i punës, përgjegjësitë, po kështu në këtë rregullore nuk ka ndarje detyrash për secilin specialist.

Për periudhën e audituar, gjatë vitit 2017 nga të gjithë sektorët e drejtorisë janë hartuar hartat e proceseve të punës, por nuk janë të miratuara, kurse për vitin 2018 në zbatim të urdhërit të Drejtorit Ekzekutiv nr. 277, datë 19.03. 2018 “Për hartimin dhe dorëzimin e regjistrit të riskut, gjurmët e auditit dhe hartën e proceseve të punës nga drejtoritë dhe zyrat rajonale/vendore”, janë hartuar hartat e proceseve të punës dhe janë miratuar nga Drejtori Ekzekutiv.

e. Vlerësimeve mbi performancën e punës së stafit.

Nga auditimi rezultoi se performanca e punonjësve është kryer nga eprorët direkt çdo 6- mujor, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Për periudhat e vitit 2017 dhe 6- mujorin i parë i vitit 2018, rezultoi se janë plotësuar dhe janë depozituar në dosjet personale të punonjësve vlerësimet e punës së tyre. Ato ishin të konfirmuara nga specialisti përkatës dhe eprori direkt, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.. Sa më lart nuk u konstatuan parregullsi.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale Drejtoria e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave në bashkëpunim me Sektorin e Trajnimeve ka trajnuar punonjësit e saj.

Kështu për vitin 2017 punonjësit e kësaj drejtorie kanë marrë pjesë dhe janë trajnuar për temat si më poshtë:

- “Ndërtimi i Modelit të Shërbimeve Publike me në Qendër Qytetarin” (2 pjesëmarrës)
- “Ndërtimi i Modelit të Shërbimeve Publike me në Qendër Qytetarin” (1 pjesëmarrës)
- “Ndërtimi i Modelit të Shërbimeve Publike me në Qendër Qytetarin” (1 pjesëmarrës)

Gjatë vitit 2018 për rritjen e kapacitetit të tyre profesional punonjësit e Drejtorisë së Financës dhe Administrimit të të Ardhurave kanë kryer trajnim me temë:

- “Sistemi i menaxhimit të Burimeve Njerëzore (1 pjesëmarrës)
- “Prezantimi i Udhëzimit të Ri Standard të përgatitjes së Programit”(3 pjesëmarrës)
- “Metodologjia për vlerësimin e ndikimit rregullator”(2 pjesëmarrës)
- “Menaxhimi i Ndryshimeve”(1 pjesëmarrës)
- “Detajimi i Buxhetit për vitin 2019” (2 pjesëmarrës)
- “Menaxhimi i fondeve të asistencës financiare të BE-së”
- “Nryshimet në legjislacionin e prokurimit publik” (2 Pjesëmarrës)
- “Marrëveshja Kuadër (2 pjesëmarrës)

Nga auditimi u konstatua se, në drejtori nuk ka një plan vjetor trajnimesh për punonjësit e saj, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë), paragrafet “Politikat dhe praktikrat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”.

2. Menaxhimi i riskut

Menaxhimi i riskut të institucionit është i rëndësishëm për arritjen e objektivave të ADISA si dhe për përcaktimin e përgjegjësive të përshtatshme ndaj këtyre risqeve. Për periudhën e audituar është hartuar dhe miratuar Rregullore për Menaxhimin e riskut me VKD nr.3, datë 25.04.2017. Në lidhje me hartimin dhe miratimin e regjistrit të rriskut, gjurmëve të auditimit dhe hartën e proceseve të punës, rezultojnë se kjo drejtori ka hartuar për vitin 2017 këto komponentë por nuk i ka miratuar nga Drejtori Ekzekutiv, për vitin 2018 me urdhërin nr. 277, datë 19.03 2018 “Për hartimin dhe dorëzimin e regjistrit të riskut, gjurmët e auditit dhe hartën e proceseve të punës nga drejtoritë dhe zyrat rajonale/vendore”, janë hartuar dhe miratuar këto komponentë të cilët kanë të përcaktuar dhe masat që do merren për minimizimin e rrisqeve sipas sektorëve.

Regjistri i riskut është përditësuar në varësi të ndryshimeve të riskut (mund të lindin risqe të reja ose të zbuten ato ekzistuese), në të janë përfshirë risqet më të rëndësishme që kanë lidhje me realizimin e objektivave të drejtorisë si dhe niveli i rëndësisë së tyre.

Aktiviteti i kontrollit.

Gjatë aktiviteteve të ndryshme të punës kryhen kontrole të caktuara që kanë të bëjnë me ndarjen dhe plotësimin e detyrave reduktimin e risqeve dhe përmbushjen e objektivave. Për saktësimin e të dhënave në një dokument respektohet parimi i katër syve nënshkrimi i dy punonjësve.

Në lidhje me procedurat dhe autoritetin për delegimin, transferimin dhe regjistrimin e autorizimit standard dhe të rasteve të veçanta, rezultojnë se për periudhën 2017- 2018 nuk ka të miratuar një manual për kryerjen e proceseve të punës pavarësisht se këto procedura respektohen ato nuk janë të shkruara/miratuara. Gjatë vitit 2017 drejtoria ka hartuar hartën e proceseve të punës ku janë të përshkruar të gjitha proceset e punës sipas sektorëve, hallkat e vendimarrjes për këtë drejtori dhe kontrollet e brendshme të vendosura për realizimin e objektivave, këto komponentë janë dërguar me e-mail nga sektorët tek Drejtori i Drejtorisë, por nuk janë miratuar nga Drejtori Ekzekutiv.

Për vitin 2018 bazuar në urdhërin nr. 277, datë 19.03 2018 “Për hartimin dhe dorëzimin e regjistrit të riskut, gjurmët e auditit dhe hartën e proceseve të punës nga drejtoritë dhe zyrat rajonale/vendore”, janë hartuar hartat e proceseve të punës të cilat janë miratuar nga Drejtori i Drejtorisë dhe Drejtori Ekzekutiv.

Lidhur me delegimin e detyrave u konstatua se për periudhën e audituar Drejtoria e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave nuk ka deleguar detyra.

a. Për sa i përket garantimit e ruajtjes së informacionit (ruajtja e dokumentacionit), rezultojnë se ky proces kryhet në bashkëpunim me zyrën e protokollit, në përputhje me rregullat në fuqi, për përcaktimin e niveleve të fshehtësisë së informacionit dhe kofidencialitetin.

Drejtorja gjatë zhvillimit të veprimtarisë së saj deri në momentin e auditimit ka protokolluar dokumentacionin që i përket Sektorit të Financës dhe Sektorit të Prokurimeve sipas legjislacionit në fuqi kurse Planet Vjetore të punës, Raporte, Analiza, etj , janë dërguar në mënyrë elektronike.

Me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin e veprimtarisë së drejtorisë, gjatë vitit 2017 – 2018 janë hartuar gjurmët e auditimit në bazë të urdhërit të cituar më sipër për çdo sektor të kësaj drejtorie, në përputhje me Ligjin dhe Manualin “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

b. Për sa i përket procedurave të verifikimit, rezultojnë se ADISA i ka zbatuar procedurat e vlerësimit, kontrollit dhe monitorimit të sistemit por nuk ka të miratuar një manual të procedurave të brendshme

të institucionit. Pamvarësisht kësaj proceset e punës kontrollohen/mbikqyren në nivel hierarkik, ku përgjegjësi i sektorit është në rolin e kontrolluesit, me pas procedura kalon tek drejtori i drejtorisë i cili e konfirmon atë dhe më pas procedura kalon tek Drejtori Ekzekutiv i cili miraton/aprovon atë.

4. Informacioni dhe komunikimi.

Informimi dhe komunikimi është një proces thelbësorë për zbatimin e gjithë objektivave të kontrollit të brendshëm. Nga auditimi rezulton se në Drejtorinë e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave komunikimi realizohet në mënyrë shkresore dhe në formë elektronike.

-Në lidhje me identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse, rezulton se informacioni përgatitet dhe dërgohet nga specialisti të përgjegjësi dhe nga përgjegjësi të Drejtori i Drejtorisë në formë shkresore për vetë natyrën e punës që kanë Sektori i Financës dhe Sektori i Prokurimeve, gjithashtu informacioni dërgohet dhe në formë elektronike për të garantuar që informacioni të merret i plotë, i saktë dhe në kohën e duhur.

5. Monitorimi.

Në lidhje me ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit rezultoi se sistemet e kontrollit të brendshëm janë ngritur me qëllim vlerësimin e sistemit të cilësisë së performancës në kohë. Në Drejtorinë e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave sistemi i monitorimit të kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet monitorimit në vazhdimësi dhe vlerësimeve të shkëputura. Monitorimi kryhet nëpërmjet monitorimit dhe performancës së shpenzimeve buxhetore, analizave të buxhetit sipas periudhave të përcaktuara në ligjin dhe VKM për buxhetin nga Ekipi i Menaxhimit të Programit dhe Sektori i Financës. Për monitorimin e proceseve dhe aktiviteteteve për ADISA në përgjithësi nga kjo drejtori janë hartuar dhe raportuar realizimi i buxhetit, produktet, treguesit dhe indikatorët e miratuar për monitorimin e strategjive dhe objektivave si dhe standardet e përcaktuara në PBA.

Konkluzion; Për sa trajtuar më sipër arrijmë në kokluzionin se drejtorja në përgjithësi pavarësisht nga mangësitë e konstatuara ka një sistem të kontrollit të brendshëm që funksionon mirë. Sistemi paraqitet me risk të ulët.

3. Si kanë funksionuar sektorët në varësi të drejtorisë për të realizuar detyrat, si kanë bashkëvepruar punën me sektorët e tjerë e zyrat pritëse, si është zbatuar rregullorja e brendëshme dhe legjislacioni në fuqi.

Drejtorja e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave ka në përbërje të saj 3 sektorë Sektori i Financës, Sektori i Prokurimeve si dhe Sektori i Administrimit të të Ardhurave dhe Menaxhimit të Projekteve, me një numër punonjësish të miratuar gjithsej 13 punonjës. Veprimtaria e këtyre sektorëve është Audituar bazuar në funksionimin e sistemit Financiarë dhe të Perputhshmerisë si më poshtë:

Auditim i Sistemit Financiar

- Hartimi dhe planifikimi i programit ekonomik për periudhën e audituar, ndjekja dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas zërave dhe kryerja e analizave periodike e vjetore mbi ecurinë e realizimit të treguesve të programit ekonomik për këtë periudhë, pasqyrimi i saktë në bilancin e fundvitis.

Për vitin 2017, Janë hartuar dhe miratuar kërkesat buxhetore sipas kritereve ligjore nga të gjitha drejtoritë dhe Zyrat Vendore/Rajonale të ADISA në përgjigjë të kërkesës së bërë nga Drejtoria e Financës me shkresë nr.6 prot, datë 09.01.2017 “Kërkesë mbi nevojat buxhetore të drejtorive për detajimin e zërit 602 (shpenzime operative).

Bazuar në këto kërkesa buxhetore dhe objektivat e ADISA për vitin 2017, kjo drejtori ka hartuar projekt-buxhetin të ndarë në programe dhe projekte. Planifikimi buxhetorë për vitin 2017 është bërë në mbështetje të ligjit nr.9938, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2/2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit nr.10 datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, për fazën e parë është përcjellë Ministrisë së Financave me shkresën nr, 437 prot, datë 24.04.2017 kërkesa për Programin Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 (faza e I), sipas afateve të përcaktuara në ligjin për buxhetin.

Me shkresën nr. 921 prot, datë 28.08.2017 ADISA ka dërguar në Ministrinë e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike kërkesat e rishikuara të PBA 2018- 2020 (Faza II). Hartimi i treguesve të projektbuxhetit për fondin e pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është bërë në përputhje me dispozitat ligjore për to. Hartimi i treguesve të projektbuxhetit për vitin 2017, për fondin e shpenzimeve korrente dhe për investimet, është bërë mbështetur në realizimin e viteve të kaluara, si dhe nevojave në përputhje me objektivat prioritare të ADISA.

Me shkresën nr.827 prot, datë 18.07.2017 “Kërkesë për çelje të fondeve të akorduara nga Fondi i Zhvillimit të Rajonit për projektet e mbartura nga viti 2016 të programit “ Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike” për ADISA është kërkuar çelja e fondeve për projektin e mbartur që në vitin 2016.

Për vitin 2018 (8 mujori) Janë hartuar dhe miratuar kërkesat buxhetore sipas kritereve ligjore nga të gjitha Drejtoritë dhe Zyrat Vendore/Rajonale të ADISA në përgjigje të kërkesës së bërë nga Drejtoria e Financës me shkresë nr .1179 prot, datë 12.12.2017“Kërkesë mbi nevojat buxhetore të drejtorive për detajimin e zërit 602 (shpenzime operative).

Nga Drejtoria e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave në mbështetje të nenit 65 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 (të ndryshuar) dhe Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 të M.F “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetorë afatmesëm” dhe Udhëzimit nr.7/1, datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e programit buxhetorë afatmesëm 2019-2021”, me shkresën nr.381 prot, datë 30.04.2018 “Dërgohen kërkesat e programit buxhetorë afatmesëm 2019-2021, janë dërguar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë” kërkesat e buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2019-2021 sipas afateve të përcaktuara në ligjin për buxhetin.

Hartimi i treguesve të projektbuxhetit për fondin e pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është bërë në përputhje me dispozitat ligjore për to. Hartimi i treguesve të projektbuxhetit për vitin 2018, për fondin e shpenzimeve korrente dhe për investimet, është bërë mbështetur në realizimin e viteve të kaluara, limitet e shpenzimeve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave si dhe nevojave në përputhje me objektivat prioritare të ADISA për vitin 2018.

- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Grupi i auditimit ka shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtë:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore për vitin 2017 (në 000/lekë)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:				
Granti i Qeverisë –Buxheti	142,780	142,780	117,329	76,846
Fondi i Zhvillimit të Rajoneve + Financim i Huaj	306,441	277,141	297,519	184,395
Totali	449,221	419,921	414,848	260,531

Fondet buxhetore për ADISA janë realizuar nga të ardhurat nga Buxheti i Shtetit, Fondi i Zhvillimit të Rajoneve dhe nga Financimi i Huaj në total ky fond është realizuar në vlerën prej 419,921 mijë lekë nga 449,921 mijë lekë të planifikuara në fillim të vitit. Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është pakësuar për 29,300 mijë lekë. Në vitin 2017 ADISA ka përdorur rreth 98.7 % të buxhetit final ose 5.073 mijë lekë më pak. Krahasuar me vitin 2016 janë përdorur 154,317 mijë lekë më shumë, më poshtë jepen shpjegimet për realizimin në fakt për vitin 2017.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2017 paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve:

Periudha Janar-Dhjetor
2017

000/lekë

Artikulli	Emertimi	Plan 2017	Buxheti vjetor, shtesa e pakesime	Buxheti vjetor final	Fakti 2017	Diferenca 2017
600	Paga	101,107	0	101,107	85,025	16,082
601	Sigurime Shoqërore	21,673	0	21,673	14,063	7,610
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	20,000	0	20,000	18,241	1,759
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	142,780	0	142,780	117,329	25,451
230	Kapitale të Patrupëzuara	154,441	0	154,441	152,777	1,664
231	Kapitale të Trupëzuara	152,000	-29,300	122,700	144,742	+22,042

<i>Nen - Totali</i>	<i>Shpenzime Kapitale</i>	306,441	-29,300	277,141	297,519	+20,378
Totali	Korrente dhe Kapitale	449,221	-29,300	419,921	414,848	-5,073

Shpenzimet kapitale (zërat 230 +231) janë planifikuar në vlerën 306,441 mijë lekë, pakësuar gjatë vitit në vlerën 29,300 mijë lekë, buxheti i miratuar është në vlerë 277,141 mijë lekë, realizuar në fakt gjatë vitit 2017 në vlerën 297,519 mijë lekë. Mosrealizimi për vitin 2017 është në vlerën 20,378 mijë lekë.

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezultojnë se: Shpenzimet gjithsej nga 449,221 mijë lekë të planifikuara në fillim të vitit pas shtesave dhe pakësimeve ka pësuar ndryshime duke bërë që buxheti faktik i miratuar për vitin 2017 të jetë në vlerën 419,921 mijë lekë realizuar në fakt për këtë periudhë në vlerën 414,848 mijë lekë ose në masën 98.7 %.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim :

- Buxheti final për pagat dhe shtesat është i njëjtë me buxhetin fillestar të planifikuar. Realizimi i buxhetit në këtë kategori është në masën 84 %. Ky realizim vjen si rezultat i numrit faktik të të punësuarve gjatë vitit 2017 (139 punonjës nga 160 të miratuar).
- Buxheti final për sigurime shoqërore është i njëjtë me buxhetin fillestar të planifikuar. Realizimi i buxhetit në këtë kategori është në masën 65 % .
- Buxheti final për mallrave dhe shërbimeve është i njëjtë me buxhetin fillestar të planifikuar. Realizimi i buxhetit në këtë kategori është në vlerën 18,241 mijë lekë ose 1,759 mijë lekë më pak se buxheti i miratuar shprehur në përqindje në masën 91% .
- Buxheti final i investimeve kapitale është planifikuar në vlerën 306,441mijë lekë, miratuar në vlerën 277,141 mijë lekë, realizuar në vlerën 297,519 mijë lekë ose 20,042 mijë lekë më shumë se buxheti i miratuar, shprehur në përqindje realizimi i këtij zëri për vitin 2017 është në masën 107 % (në këtë tejkallim ka ndikuar financimi i huaj i cili ka realizuar buxhetin në shumën 123 %).

Për vitin 2018 deri në momentin e auditimit buxheti i miratuar ka pësuar ndryshime në masën 5,000,000 lekë nga zëri 600 (paga) në zërin 602 (shpenzime operative), në total buxheti nuk ka pësuar ndryshime.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2018 paraqitet si më poshtë në 000/lekë.

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:				
Granti i Qeverisë –Buxheti	171,769	171,769	88,689	117,329
Investime të Brendshme	97,000	97,000	27,451	55,410
Financim i Huaj	150,000	150,000	35,568	159,668

Për periudhën Janar – Gusht 2018 janë përgatitur dhe paguar të gjitha detyrimet që ka Institucioni me punonjësit e tij dhe me palë të treta. Në fund të muajit Gusht 2018, realizimi i fondeve për zërat 600 (Shpenzime page), 601 (shpenzime sigurime shoqërore e shëndetësore) dhe 602 (shpenzime operative) është sipas tabelës më poshtë:

Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve:

Periudha Janar-Gusht 2018
në 000/lekë

Artikulli	Emertimi	Plan 2018	Buxheti vjetorë plan i rishikuar	Buxheti vjetorë plan i periudhës /progresive	Fakti 8 mujori 2018	Diferenca
600	Paga	130,000	107,780	82,000	64,003	17,997
601	Sigurime Shoqërore	21,769	21,490	15,000	10,612	4,388
602	Mallra dhe Shërbime	20,000	25,000	19,000	14,076	4,924
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	171,769	154,270	116,000	88,691	27,309
	Financim i brendshëm					
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	-	-	-	-
231	Kapitale të Trupëzuara	97,000	97,000	97,000	27,451	69,549
	Financim I huaj					
230	Kapitale të Patrupëzuara	80,000	80,000	50,000	31,525	18,475
231	Kapitale të Trupëzuara	70,000	70,000	50,000	4,043	45,957
Nen - Totali	Shpenzime Kapitale	247,000	247,000	197,000	63,019	133,981
Totali	Korrente dhe Kapitale	418,769	401,270	313,000	151,710	161,290

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme për vitin 2018 rezulton se: **Shpenzimet gjithsej** për 8-mujorin e vitit 2018 nga **313,000** mijë lekë të miratuara janë realizuar në vlerën **151,710** mijë lekë ose në masën **48 %** të shpenzimeve të miratuara.

Progresiv për gjithë vitin 2018 shpenzimet gjithsej janë realizuar në vlerën prej 236,405 mijë lekë ose në masën **75.5 %** në krahasim me planin.

Shpenzimet për artikullin **“Paga dhe Sigurime”** nga 97,000 mije lekë të miratuara për 8 mujorin, janë realizuar në fakt për këtë periudhë në vlerën 74,615 mijë lekë ose 22,385 mijë lekë më pak se planifikimi, krahasuar në përqindje këto shpenzime janë realizuar në masën **77 %** , Progresiv për gjithë vitin 2018 shpenzimet për pagat dhe sigurimet janë realizuar në vlerën 112,166 mijë lekë ose në masën **87 %** në krahasim me planin e miratuar.

Shpenzimet për artikullin **“Mallra dhe shërbime 602”** nga 19,000 mijë lekë të miratuara për 8-mujorin, janë realizuar në fakt për këtë periudhë auditimi në vlerën 14,076 mijë lekë ose 4,924 mijë lekë më pak se plani, krahasuar në përqindje këto shpenzime janë realizuar në masën **74 %** në krahasim me planin e miratuar.

Progresiv për gjithë vitin 2018 shpenzimet operative janë realizuar në vlerën 24,693 mijë lekë ose në masën 98 % në krahasim me planin e miratuar .

Shpenzimet për artikullin “Shpenzime kapitale” me financim të brendshëm nga 97,000 mijë lekë të miratuar për 8- mujorin, janë realizuar në vlerën 27,451 mijë lekë , ose 69,549 mijë lekë më pak se planifikimi, krahasuar në përqindje këto shpenzime janë realizuar në masën 28 % në krahasim me planin e miratuar.

Progresiv për gjithë vitin 2018 shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar në vlerën prej 38,925 mijë lekë, ose në masën 73 % në krahasim me planin e miratuar.

Shpenzimet për artikullin “Shpenzime kapitale” me financim të huaj nga 100,000 mijë lekë të miratuar për 8- mujorin janë realizuar në vlerën 35,566 mijë lekë ,ose 64,434 mijë lekë më pak se planifikimi, krahasuar në përqindje këto shpenzime janë realizuar në masën 28 % në krahasim me planin e miratuar.

Progresiv për gjithë vitin 2018 shpenzimet kapitale me financim të huaj janë realizuar në vlerën 110,000 mijë lekë , ose në masën 110 % në krahasim me Buxhetin e miratuar.

Sipas këtyre të dhënave totali i realizimit të buxhetit të planifikuar është në masën 75.5 % të totalit të përgjithshëm. Ecuria e realizimit të buxhetit për këtë periudhë paraqitet e mirë duke ju referuar totalit të shpenzimeve të realizuara në krahasim me ato të planifikuara për vitin 2018.

Për vitin 2017

Me Urdhër nr.2/1, datë.20.20.2017 është ngritur Grupi i Menaxhimit të Projekteve (EMP), po kështu me Urdhër nr.1, datë 04.01.2017 2017 është ngritur Grupi i Menaxhimit të Riskut (GMS).

Nga Ekipi i Menaxhimit të Programit në bashkëpunim me Sektorin e Financës është përgatitur Raporti i Monitorimit për vitin 2017 dhe është dërguar në Ministrinë e Financës dhe Ministrinë e Inovacionit me shkresën nr.644 prot, , datë 08.06.2017 “Mbi performancën financiare buxhetore të ADISA për periudhën 4-mujore Janar-Prill 2017”.

Për vitin 2017 për periudhën 8-mujore nga Ekipi i Menaxhimit të Projektit në bashkëpunim me Sektorin e Financës është përgatitur Raporti i monitorimit i cili është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Inovacionit me shkresën nr.994 prot, datë 02.10.2017 “Dërgohet Raporti i Monitorimit për 8- mujorin e vitit 2017” (Janar –Gusht).

Për periudhën 12- mujore nga Ekipi i Menaxhimit të Projektit në bashkëpunim me Sektorin e Financës është përgatitur Raporti i Monitorimit dhe është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Inovacionit më shkresën nr.133 prot, datë 05.02.2018 “Mbi performancën financiare buxhetore të ADISA për 12- mujorin e vitit 2017.

Për vitin 2018

Është ngritur Ekipi i Menaxhimit të Projekteve (EMP) me urdhër nr.71 prot, datë 09.01.2018 “Për krijimin e EMP për vitin 2018” dhe Grupi i Menaxhimit të Riskut (GMS) me urdhër nr.70 prot, datë 19.01.2018 për vitin 2018 “Për krijimin e GMS për vitin 2018” është ndryshuar GMS me Urdhërin nr.71/1 prot, datë 18.06.2018.

Nga Grupi i Menaxhimit të Projekteve në bashkëpunim me Sektorin e Financës është përgatitur dhe dërguar me shkresën nr.503/1, date 12.06.2018 (Raporti i Monitorimit për periudhën Janar- Prill 2018) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Nga ky grup është përgatitur dhe dërguar me shkresën nr.71/2 prot, datë 26.09.2018 “Dërgohet Raporti i Monitorimit” në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”.

Konkluzion

Sistemi i ngritur për planifikimin dhe realizimin e treguesve të zërave të buxhetit, ndjekjen dhe raportimin e performancës buxhetore ka qenë efektiv. Realizimi i buxhetit për periudhën e audituar ka rezultuar i kënaqshëm duke realizuar objektivat e vendosur në fillim të vitit nga ADISA po kështu janë respektuar afatet për përgatitjen dhe raportimin e performancës buxhetore të ADISA në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 (të ndryshuar), Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 të M.F “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetorë afatmesëm” dhe Udhëzimit nr.7/1, datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e programit buxhetorë afatmesëm 2019-2021”.

- Administrimi i vlerave materiale në magazinë nëpërmjet mbajtjes e pasqyrimit në kontabilitet si në sasi ashtu dhe në vlerë për periudhën korrik 2017 deri në Qershor 2018. Dokumentimi i lëvizjes së hyrje daljeve nga magazina dhe dokumentacioni i përdorur në këtë rast, rakordimi sipas periudhave kohore, evidentimi e saktësimi i inventarizimit në fund të vitit.

Nga auditimi i bilancit kontabël dhe pasqyrave financiare, për vitin 2017 rezultoi se këto pasqyra janë dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr.202 prot, datë 28.02.2018 duke respektuar afatet ligjore të përcaktuara.

Sistemi i kontabilitetit në ADISA mbahet me anë të programit Alfa,i cili garanton sigurinë e informacionit dhe është i printueshëm në çdo kohë. Veprimet kontabël janë kryer konform dispozitave ligjore në fuqi, ku çdo regjistrim është bërë në bazë të dokumentave justifikuese, si dhe janë zbatuar parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Nga auditimi i ditarëve dhe librave kontabël rezultoi se organizimi i kontabilitetit, është në pajtim me kërkesat e ligjit nr.9224, date 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, veprimet janë të rregullta, plani i llogarive ishte përpiluar në përputhje me kërkesat e planit të përgjithshëm kontabël.

Mbajtja e kontabilitetit bëhet në mënyrë të kompjuterizuar. Regjistrimet kontabël janë mbështetur në dokumenta justifikues dhe llogaritë janë të analizuara dhe të rakorduara.

Regjistrimi në kontabilitet i daljeve nga magazina është bërë me çmimin e blerjes dhe amortizimi i tyre llogaritet në fund të vitit ushtrimore.

Për vitin 2017, 2018 nga Sektori i Financës, regjistrimi i hyrjeve daljeve të aktiveve nga magazina është bërë në përgjithësi duke respektuar kërkesat e ligjit nr.9228 datë 29.04.2004 i ndryshuar, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimit MF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, të gjitha lëvizjet e vlerave materiale nga magazina kryhej nëpërmjet fletë hyrjeve e daljeve si dhe dokumentacioni justifikues bashkangjitur.

Regjistrimi në ditarë i hyrje – daljeve të aktiveve.

Për aktivet e blera janë debituar llogaritë e klasës 2 (231,218) në kredi të klasës 4 (401) , me ndërmjetësimin e llogarisë 231 është kredituar llogaria 218 , në kredi të llogarisë 231 për vlerën e aktiveve të qëndrueshme të bëra hyrje. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme në fund të vitit ushtrimore është paraqitur me vlerën neto.

Mënyra e mbajtjes së inventarit është sipas inventarit kontabël të përhershëm që mundëson njohjen në kohë gjatë ushtrimit të gjendjeve ekzistuese të sasisë dhe në vlerë për çdo artikull. Llogaria 312,327 kanë funksionuar si llogari magazinë ku përveç gjendjes në çelje të ushtrimit, këto llogari regjistrojnë sistematikisht gjatë gjithë ushtrimit cdo lëvizje (hyrje – dalje) të ndodhur.

Për hyrjet nga blerjet gjatë ushtrimit këto llogari janë debituar në kredi të llogarisë 602 regjistrim i njëkohshëm me atë në debit e llogarive të blerjeve klasa 6 dhe kredi të llogarisë 401 furnitor.

Për daljet gjatë vitit ushtrimor llogaritë e gjendjes së inventarit janë kredituar në debit e llogarisë 602.

Në lidhje me dokumentimin e lëvizjes së mallrave e materialeve (hyrje-daljet), dokumentacionin e përdorur në këtë rast, funksionimi i urdhër furnizimit etj, u auditua zbatimi i procedurave ligjore për lëvizjen e mallrave dhe materialeve nga magazina si për hyrjet dhe për daljet dhe rezultoi se:

Hyrja e mallrave në magazinë dokumentohej me fletë hyrje e hartuar sipas gjendjes fizike të mallrave dhe materialeve. Për blerjet me procedura tenderimi hyrjet janë bërë sipas kontratave të furnizimit duke i bashkëngjitur nga sektori i financës gjithë dokumentacionin autorizues. Pritja dhe verifikimi i mallrave është bërë nga komisionet e ngritura sipas urdhërave nga Titullari i Institucionit. Daljet nga magazina janë dokumentuar me fletëdalje të shoqëruar me urdhër dorëzimi të plotësuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve bazuar në kërkesat sipas sektorëve. Për aktivet e dala për përdorim të punonjësve janë plotësuar kartelat personale për çdo punonjës. Por nga

auditimi i lëvizjes së mallrave e materialeve dhe dokumentimit të tyre nëpërmjet fletë hyrjeve e daljeve, u konstatua se:

Gjetje nga auditimi

Nga Sektori i Marketingut dhe Komunikimit si dhe mirëmbajtësi i godinave janë tërhequr nga magazina mallra e materiale për promovimin e ADISA në aktivitete të ndryshme, si dhe për riparimin e defekteve të ndodhura në zyrat ADISA dhe Zyrat Pritëse nëpër rrethe, por fletë dalje nuk kanë të bashkëngjitur dokumenta justifikues se ku u përdorën këto mallra dhe materiale si në rastin e Fl.d nr.65, dt.28.03.2017 tërhequr 30 USB me 8 GB me vlerë 12.3018 lekë, Fl.d nr.133, datë 05.09.2017 tërhequr mallra dhe materiale inventari me vlerë 2,778,400 lekë, Fl.d nr.216 dt.06.12.2017 tërhequr materiale promovimi me vlerë 443.984 lekë.

- Drejtoria e Administrimit të Brendshëm (Sektori i Shërbimeve Mbështetëse) nuk ka ushtruar kontrollin e duhur dhe nuk ka evidentuar mangësitë në kërkesat e kryera nga punonjësit e ADISA, kjo referuar kryesisht mallrave dhe materialeve të tërhequra nga Sektori i Marketingut (i cili ka tërhequr nga magazina jo vetëm materialet që i nevojiten për realizimin e objektivave, por ka tërhequr dhe uniformat e punonjësve të Zyrave Pritëse ADISA) të cilat nuk i ka administruar siç duhet pasi nuk ka të evidentuar se ku janë përdorur këto materiale, sa nga këto materiale janë përdorur dhe sa prej tyre janë kthyer në magazinë (një pjesë e tyre aktualisht janë gjendje në magazinë).

- Magazinieri nuk ka evidentuar me dokumenta se cilat materiale janë kthyer në magazinë dhe sa janë në ruajtje, të gjitha këto veprime bien në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 ‘Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik’.

U rekomandua që titullari i institucionit të nxjerrë urdhër të brendshëm dhe të kërkojë zbatimin e tij që Drejtoria e Administrimit të Brendshëm për të gjitha materialet që nxirren nga magazina ADISA, të përcaktojë një normativë shpërndarje, kështu për materialet e konsumit që përdoren në Zyrat qendrore të ADISA dhe Zyrat Pritëse nëpër rrethe të hartohet një kartelë limit shpërndarje, për materialet që përdoren për promovimin e ADISA në aktivitete të ndryshme dhe shpërndarjen e tyre në Zyrat Vendore /Rajonale si dhe materialet që përdoren për riparime të ndryshme, nga personi përgjegjës që tërheq mallin nga magazina të hartohet një MEMO informuese/ose preventiv shpenzimesh /ose proces verbal, duke përcaktuar aktivitetin ose Zyren Pritëse ADISA në të cilin janë përdorur dhe shpërndarë këto materiale duke i evidentuar në sasi, e njëjta mënyrë do përdoret dhe nga mirëmbajtësi i godinave për materialet e përdorura gjatë riparimeve të ndryshme, këto dokumenta ti bashkëlidhen Fletë daljeve të magazinës të cilat regjistrohen në kontabilitet nga Sektori i Financës.

- Drejtoria Ekonomike, për periudhën në vazhdim të ushtrorë kontrole të vazhdueshme mbi dokumentacionin shoqëruar që justifikojnë hyrje- dalje nga magazina dhe të kërkojë plotësimin e tyre përpara regjistrimit në kontabilitet të këtyre dokumentave.(Rëndësia/Risk i lartë)

Nëpunësi përgjegjës me shkresën nr.1014/4 prot, datë 09.04.2019 është shprehur dakort me gjetjen dhe rekomandimin e lënë kështu që gjetja do të pasqyrohet dhe në Raportin Final të Angazhimit.

Konkluzion

Sistemi i ngritur për administrimin e vlerave materiale në magazinë ka funksionuar me mangësi, (sistemi paraqitet me risk të lartë)

- Kryerja e inventarëve periodik e vjetor të mallrave në magazinë e në institucion, mallrat me qarkullim të ngadalshëm apo stok, nxjerrja e mallrave e materialeve jashtë përdorimit në përputhje me aktet ligjore.

Gjatë vitit 2017, 2018 nga Sektori i Financës janë kryer rekordimet periodike (çdo muaj) midis gjendjes kontabël dhe gjendjen fizike të mallrave e materialeve në magazinë në sasi, çmim, vlerë dhe nuk kanë rezultuar diferenca.

Me Urdhërin nr.1186 prot, datë 13.12.2017 “Për kryerjen e inventarizimit të asetëve (aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatshkurtra)” është ngritur komisioni i inventarizimit i përbërë nga 5(pesë) anëtar. Inventarizimi është kryer në magazinën e ADISA, në Zyrat Qëndrore ADISA si dhe në Zyrat Vendore/Rajonale nëpër rrethe. Mbi bazën e inventarëve analitikë janë përpiluar inventarët sintetik si shuma e tyre, të detajuar sipas llogarive inventariale.

Llog 215 (aktive afatgjatë mjete transporti) 29,922,090 lekë.

Llog 21 (aktive afatgjata materiale) 116,320,032 lekë.

Llog 327 (inventarë i imët) 3,536,133.99 lekë

Llog 312 (Magazina) 5,618,757 lekë

Shumat e të cilave përputhen me të dhënat në bilanc.

Amortizimi është llogaritur në zbatim të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar duke përdorur normat e amortizimit të përcaktuara nga ky udhëzim.

- Raportimi i i pasqyrave financiare

U auditua raportimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 dhe u konstatua se pasqyrat janë plotësuar konformë Planit Kontabël të miratuar me VKM nr.9228, datë 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.14 datë 28.12.2006. Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore per institucionet qendrore”.

Bilanci është rakorduar në të gjitha pasqyrat përkatëse në aktiv e pasiv, llogaritë analitike kuadrojnë me ato sintetike. Llogaritë inventariale janë të barabarta me të dhënat e pasqyruara në aktivet e bilancit.

Sipas pasqyrave të bilancit me datë 31.12.2017 ADISA ka një vlerë neto aktivesh të ndarë në AQT në vlerën 223,430,963 lekë, AQPT në vlerë 260,650,996 lekë dhe Aktive Qarkulluese në vlerën 9,155,290 lekë, me një amortizim vjetor të akumuluar prej 22,497,632 lekë. Në fund të vitit ushtrimor nuk janë bërë dalje nga përdorimi të aktiveve.

Gjetje nga auditimi

Në përfundim të inventarizimit të kryer në ADISA, Komisioni i inventarizimit ka evidentuar disa materiale për jashtë përdorimit në vlerën prej 26,306.56 lekë dhe me Memon nr.1186/1 dt.10.01.2017 me subjekt “Mbi inventarizimin e aktiveve afatgjata materiale e jomateriale dhe afatshkurtra” ka informuar Nëpunësin Autorizues dhe Nëpunësin Zbatues. Nga auditimi i dosjes së inventarit të vitit 2017 nuk rezultoi se nga Nëpunësi Autorizues është nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e materialeve të propozuara dhe nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit në kundërshtim me Udhëzimin nr.30 dt.27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar “Procesi i Vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi”.

U rekomandua që Nëpunësi Autorizues në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të marrë masa që pas përfundimit të inventarizimit të shqyrtojë rezultatet e dala nga inventarizimi, të nxjerrë urdhër për ndjekje nga Nëpunësi Zbatues në lidhje me kompensimet dhe sistemimin e diferencave nëse ka, gjithashtu Nëpunësi Autorizues të nxjerrë urdhër për ngritjen e grupeve të punë për vlerësimin e aktiveve të propozuara për jashtë përdorimit dhe asgjësimin e tyre nga komisioni i ngritur për këtë procedurë, konformë me Udhëzimin nr.30 dt.27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar.(Rëndësia/Risk i mesëm)

Nëpunësi përgjegjës me shkresën nr.1014/4 prot, datë 09.04.2019 është shprehur dakort me gjetjen dhe rekomandimin e lënë kështu që gjetja do të pasqyrohet dhe në Raportin Final të Angazhimit.

Konkluzion

Sistemi i financiar ka funksionuar me mangësi në administrimin e materialeve të magazinës, në ushtrimin e kontroleve të dokumentave justifikues për hyrje daljet e kryera nga magazina si dhe në shqyrtimin e rezultateve të dala në përfundim të inventarizimit.
(Funksionimi i sistemit paraqitet me risk të lartë)

Auditim i Sistemit të Përputhshmërisë.

Mbi ndjekjen e realizimin e shpenzimeve për pagat, sigurimet shoqërore, shpenzime për udhëtim e dieta brenda e jashtë vendit, shpenzime të tjera, dokumentimi i këtyre shpenzimeve në përputhje me treguesit e programit ekonomik dhe aktet ligjore në fuqi.

- Realizimi i buxhetit për paga e sigurime në përputhje me buxhetin e planifikuar.

Për periudhën e audituar zëri paga për vitin 2017 nga 101.107 mijë lekë i programuar është realizuar në vlerën prej 85.025 mijë lekë ose 84,9 % e programit dhe më pak nga 16.082 mijë lekë, zëri “sigurime shoqërore” sipas programit ekonomik është parashikuar në vlerën prej 21.673 mijë lekë

dhe paraqitet me një realizim në masën 64,9% ose më pak nga programi në vlerën prej 7.610 mijë lekë, arsyet e mosrealizimit si të fondit të pagave dhe atij të sigurimeve shoqërore është mosplotësimi i organikës me numrin e punonjësve të miratuar. Për periudhën janar-gusht 2018, zëri “paga” është planifikuar në vlerën prej 82.000 mijë lekë dhe realizuar në fakt në vlerën prej 64.003 mijë lekë ose 78 % e planifikimit, krahasuar me programin është realizuar më pak në vlerën prej 17.997 mijë lekët , zëri “sigurime shoqërore” është planifikuar në vlerën prej 15.000 mijë lekë , realizuar në fakt në vlerën 10.612 mijë lekë ose në masën 70,7% të planifikimit, diferenca është në vlerën prej 4.388 mijë lekë më pak se plani.

- *Listë pagesat, elementët dhe përputhshmëria e tyre me procedurat e kontrollit dhe përpunimit të tyre.*

Listëpagesat janë plotësuar me elementët e strukturës, organikës, elementët e pagës së grupit dhe të pozicionit në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Udhëzimin plotësues të M.F nr.2, datë 15.02.2012 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”. Në testin e kryer për pagën e 59 punonjësve (me zgjedhje) rezultoi se pagesat ishin korrekte, janë zbatuar me korrektësi baza ligjore për pagat e sigurimet shoqërore, listë pagesat janë të firmosura rregullisht nga Sektori i Burimeve Njerëzore, Sektori i Financës si dhe nga Nënpunësi Autorizues e Zbatues. Listë pagesave për çdo periudhë i është bashkëngjitur dhe urdhër shpenzimi i bankës si dhe përmbledhësja e listëpagesës të cilat nuk rezultuan devijime midis tyre. Nga auditimi duke krahasuar urdhërin e brendshëm për emërimin e punonjësit dhe caktimin e kategorisë së pagës në mbështetje të VKM nr.654 dt.14.09.2016 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së ADISA”, i ndryshuar nuk rezultuan devijime. (testi nr.1)

Lidhur me llogaritjen dhe pagesën e kontributeve të detyrueshme, në testin e realizuar për 4 muaj për 40 punonjës (me zgjedhje) rezultoi se llogaritjet dhe pagesat janë kryer konforme me legjislacionin në fuqi, po kështu u audituan dhe deklarimet dhe pagesat në sitemin tatimorë për 9 muaj (me zgjedhje) ku rezultoi se ato ishin kryer në përputhje me procedurat ligjore. (testi nr.2).

- *Sistemi i pagesave, përputhshmëria me procedurat ligjore.*

Në lidhje me sistemin e pagesave u audituan 62 U.Sh (me zgjedhje) dhe në përfundim të auditimit rezultoi se janë respektuar të gjitha procedurat ligjore (janë hartuar kërkesat për blerje mallrash dhe shërbimesh, U.Sh shoqërohet me Faturën e shitësit, mallrat janë marrë në dorëzim nga komisioni, është plotësuar fletë hyrja, shpenzimet e kryera janë vendosur në kodin e duhur të llogarisë, shpenzimet e kryera rakordojnë me sistemin e thesarit). Sistemi i pagesave ka funksionuar mirë. (Sistemi paraqitet me rrisht të ulët). (testi nr.3).

- *shpenzime për “Udhëtim e dieta”, pagesat e tyre në përputhje me aktet ligjore.*

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve të përgatitura nga Sektori i Financës u konstatua se: Me Urdhër nr.1, datë 19.01.2016 “Për Delegim Kompetence” protokolluar në ADISA me nr.70 prot, datë 22.01. 2016 Ministër Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike ka autorizuar Drejtorin Ekzekutiv të ADISA për nxjerrjen e urdhërave për dërgimin me shërbim të punonjësve jashtë

qendrës së punës brenda vendit, urdhër i cili ka funksionuar deri në momentin e ndryshimit të strukturës së Këshillit të Ministrave.

Për vitin 2017 zëri “shpenzime për udhëtime e dieta” është realizuar në masën 765.600 lekë.

Shpenzimet e realizuara për vitin 2017 për udhëtime e dieta brenda vendit janë të shoqëruara me Urdhër nga Titullari i Institucionit për ngritjen e grupeve të punës për nisjen për shërbim jashtë qendrës së punës , Urdhër shërbimi të plotësuar nga Nëpunësi Zbatues të niveleve të ndryshme , Fatura tatimore dhe Kuponi Tatimor i subjektit që ka kryer shërbimin (Fjetje) si dhe listë pagesat për punonjësit që janë nisur për shërbim konformë me VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit” i ndryshuar. Për shpenzimet jashtë vendit dokumentacioni bashkëngjitur urdhër shpenzimit është sipas VKM nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiarë të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

Për vitin 2018 (8 mujorin) zëri “shpenzime për udhëtime e dieta” është realizuar në masën 187.500 lekë.

Dokumentacioni shoqërues për shpenzimet e realizuara për udhëtime e dieta brenda vendit është në përgjithësi konformë VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”,i ndryshuar,ku janë të bashkangjitur dokumentacioni justifikues si urdhëri i brendshëm për lëvizjen duke përcaktuar dhe afatin e shërbimit,fatura e hotelit e shoqëruar dhe me kuponin tatimor si dhe dokumenta të tjera justifikuese,por nga auditimi rezultoj se për periudhën e audituar nga ana e Sektorit të financës si dhe për periudhën e mëparshme, nuk janë respektuar kërkesat e VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”,i ndryshuar,Kreu V –“Dërgimi me shërbim i punonjësit”, pika 2,gërma ii ku theksohet se dërgimi me shërbimi punonjësit autorizohet nga sekretari i përgjithshëm përkatës -, ku theksohet: “për aparatet e Presidencës,të Kuvendit,të Këshillit të Ministrave, të enteve kushtetuese si dhe për institucionet në varësi të Kryeministrit”.

Gjetje nga auditimi

Me ndryshimin e Strukturës së Këshillit të Ministrave në muajin Shtator 2017, Urdhëri Nr.1, datë 19.01.2016 i Ministër Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për delegim kompetencash” nuk ka fuqi ligjore. Urdhërat e Brendshëm të dalë për nisjen me shërbim të punonjësve, nuk janë firmosur nga nëpunësi përgjegjës sipas VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”,i ndryshuar,Kreu V “Dërgimi me shërbim i punonjësit” pika 2,gërma ii.

U rekomandua që titullari i institucionit ti drejtohet me një shkresë zyrtare Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrit për miratimin e Autorizimit për dërgimin me shërbim të punonjësve të ADISA jashtë qendrës së punës,brenda vendi, në respektim të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”,i ndryshuar, Kreu V “Dërgimi me shërbim i punonjësit” pika 2,gërma ii,

bazuar dhe në faktin që punonjësit e ADISA janë të detyruar të kryejnë lëvizje të shpeshta për arsye të natyrës së punës dhe objektivave që ka ADISA si institucion për ngritjen e Zyrave të Shërbimit në të gjithë Shqipërinë.(Rëndësia/Risk i lartë).

Nëpunësi përgjegjës me shkresën nr.1014/4 prot, datë 09.04.2019 është shprehur dakort me gjetjen dhe rekomandimin e lënë kështu që gjetja do të pasqyrohet dhe në Raportin Final të Angazhimit.

- Hartimi, miratimi dhe dërgimi në institucionet përgjegjëse të Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimit Publik, në përputhje me procedurat ligjore.

Për periudhën e audituar Sektori i Prokurimit ka hartuar planin e punës për vitin 2017, 2018, ka hartuar hartën e proceseve të punës , regjistrin e rriskut dhe Gjurmët e auditimit të cilat i ka miratuar të Drejtori i Drejtorisë. Nga ky sektor bazuar në kërkesat e hartuara nga drejtoritë në ADISA dhe Zyrat Pritëse ka përgatitur Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimit Publik, hartimi, miratimi dhe dërgimi i këtij regjistri në Ministrinë përgjegjëse, Agjencinë e prokurimit Publik dhe Degën e Thesarit Tiranë është kryer bazuar në Ligjin nr.9643 dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. (Sistemi ka funksionuar dhe paraqitet me rrisk të ulët). (testi nr.4).

- Prokurimet, përputhshmëria e procedurave prokuruese dhe e dokumentacionit të tyre me legjislacionin përkatës.

- Prokurimeve Publike me vlerë mbi 800,000 mijë lekë.

Auditimi për prokurimet me fondet publike të realizuara për periudhën e audituar,u krye në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe duke marrë për bazë dhe programimin e fondeve për investime të shpenzimeve buxhetore të programuara si dhe të regjistrit të realizimit të prokurimeve (me ndryshimet e bëra).

Nga auditimi i procedurave të prokurimit, rezultoi se Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kufirin monetar, bazuar në procedurat për secilin prokurim të kryer, në zbatim të legjislacionit të lartpërmendur, si dhe ka zbatuar afatet kohore të zhvillimit të procedurave të prokurimit që nga momenti i daljes së urdhër prokurimit deri në momentin e lidhjes së kontratave. Në dosjet e kontrolluara, rezulton se janë mbajtur rregullisht dhe në afatin kohor procesverbalet e mbledhjeve të komisionit të vlerësimit të ofertave, njoftimet e firmave pjesëmarrëse në tender, është bërë raporti përmbledhës për kryetarin e Autoritetit Kontraktor si dhe janë dërguar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve, sipas afateve të përcaktuara në VKM. Për sa më lart, rezultoi se dosjet e tenderëve janë të inventarizuara dhe arkivuara në fillim të vitit pasardhës, veprim ky që zbatohet sipas kërkesave të ligjit nr.9154, datë 06.01.2003 “Për Arkivat”.

Për vitin 2016,në bazë të regjistrit të realizimit të prokurimeve janë realizuar prokurime për mallra,shërbime e ndërtime gjithësejt 16 tendera me vlef të prej 39.859.525 lekë me tvsh,në

strukturën e saj peshën më të madhe e zënë shpenzimet për prokurime për blerje mallrash me 21.894.209 lekë ose 55% e fondeve të prokuruar.

Për vitin 2017 në bazë të regjistrit të realizimit të prokurimeve janë realizuar prokurime për mallra,shërbime e ndërtime gjithsej 15 tendera me vlerë 20.739.764 lekë me tvsh, në strukturën e shpenzimeve për prokurime, zëri për shtesë kontrate për 7 subjekte të tenderuara nga viti i kaluar është në vlerën 6.568.181 lekë ose 32% e fondeve të prokuruar.

Auditimi i fondeve të prokuruar u bë me zgjedhje për faktin se nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Menaxhimit të të Ardhurave dhe Sektorit të Prokurimit në të shumtën e tenderave për blerje e shërbime është vepruar konform VKM nr.28 dt.14.01.2015 “Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave për prokurimin publik,në emër dhe për llogari të Kryeministrisë,ministrive dhe institucioneve të varësisë për disa malla e shërbime”, i ndryshuar.

Për vitin 2018, për realizimin e prokurimeve për blerje mallra,materiale e shërbime është vepruar konform VKM nr. 673 dt.22.11.2017 “ Per riorganizimin e Agjencise Kombetare te Informacionit” dhe Shkresa nga KM nr.5830/10 dt.23.11.2017,si në rastin e kryerjes së prokurimit “Blerje desktop 2 per ADISA me fond të fituar 2.800.000 lekë pa tvsh dhe me tvsh 3.360.000 lekë nga firma “Compiuter & Copier Systems” shpk.

Nga auditimi rezultoi si më poshtë:

Në tenderat e zhvilluar për periudhën e auditimit (19 tendera me zgjedhje) nga ana e autoritetit kontraktor për blerje mallra, materiale e shërbime është vepruar konform VKM nr.28 dt.14.01.2015,i ndryshuar, por nga 19 tendera të audituar, në 6 prej tyre u konstatua se nuk janë respektuar kërkesat e kontratave të lidhura dhe baza ligjore si në:

1.Në tenderin: “Blerje Toner” “Shtesë kontrate Blerje Tonera për nevoja të fillim vitit 2017”,në kontratën fillestare me nr.551/1 dt.16.06.2016, Fondi limit :494.273,52 lek pa tvsh, Fondi i fituar:494.273,52 lek pa tvsh,firma fituese: “INFOSOFT” shpk

Procedurat e zhvillimit të tenderit janë kryer nga Ministria e Punëve të Brendshme në bazë të VKM nr.28 dt.14.01.2015 “Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik,në emër dhe për llogari të Kryeministrisë,Ministrive dhe institucioneve të varësisë,për disa mallra e shërbime”,Ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik,i ndryshuar,VKM nr.914 dt.29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të prokurimit Publik”,neni 60.Mbështetur në Udhëzimin nr.30 dt.27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,pika 37,39.

Në përfundim të auditimit të dosjes së tenderit nga grupi i auditimit u konstatua kjo gjetje:

- **Autoriteti Kontraktor ka lidhur shtesë kontrate pasi ka kaluar afati i përcaktuar, në VKM nr.914 dt.29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,neni 2,pika 3 gërma a,b,dhe pika 7,neni 36,gërma d. (testi nr.5/7)**

Rekomandim

U rekomandua që Autoriteti Kontraktor në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të përcaktojnë përgjegjësit e realizimit të procedurës së prokurimit “Shtesë kontrate Blerje Tонера për nevoja të fillim vitit 2017” me fond limit 494.273,52 lek pa tvsh, jashtë afateve të përcaktuara në kriteret ligjore.(Rëndësia/Risk i mesëm)

Nga Drejtoria Ekonomike me shkresën nr. 1014/4 prot, datë 09.04.2019 “Observacion mbi Projekt Raportin e Angazhimit të auditimit” u kthye observacion lidhur me këtë gjetje duke theksuar se:

“.....konstatojmë se baza ligjore të cilës i referohet grupi i auditimit nuk qëndron. Neni 2 ka të bëjë me rolin e organit qëndrorë blerës.Kurse neni 36,pika d gjen përdorim tek kontratat e ndërtimit ose kontratat specifike teknike.....”.

Lidhur me këtë observacion grupi i auditimit sqaron se: Për prokurimin e kryer për shtesë kontrate “Për blerje tonerë” me vleftë 494.273,52 lekë pa TVSH, në përshkrimin e bërë në projekt raportin e paraqitur vendosja e bazës ligjore është korrekte pasi ky tenderim e ka fillimin e vet nga blerja që është realizuar më parë dhe që është tenderuar në mbështetje të VKM nr.28 dt.14.01.2015 si prokurim i përqendruar si dhe e drejtë e entit prokurues për plotësimin e nevojave në vazhdim. Në arsyetimin tonë kemi konstatuar se për këtë procedurë prokurimi është vepruar në shkelje të nenit 36, gërma d, ku në fjalinë e parë theksohet se: ***Kur për lëvrime shtesë nga furnizuesi i mëparshëm,.....***, arsyetimi i nëpunësit përgjegjës se neni 36, pika d gjen përdorim për kontratat e ndërtimit ose te kontratat specifike teknike në këtë rast nuk qëndron. Në fund të këtij neni theksohet se: ***Kontrata shtesë duhet të nënshkruhet brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i kontratës fillestare dhe vlera e saj nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare.***

Koment: Grupi i auditimit nuk e ndryshon opinionin e tij lidhur me këtë gjetje, pasi konstatimet qëndrojnë dhe observacioni është vetëm i natyrës justifikuese, kjo gjetje do të pasqyrohet dhe në Raportin Final të Angazhimit

2.Në tenderin : “Blerje materiale pastrimi”,Fondi limit : 2.655.630 lek pa tvsh,fondi i fituar 2.166.950 leka pa tvsh, firma fituese “Ë CENTER” shpk.

Procedurat e zhvillimit të tenderit janë kryer nga Ministria e Punëve të Brendshme në bazë të VKM nr.28 dt.14.01.2015 “Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik,në emër dhe për llogari të Kryeministrisë,Ministrive dhe institucioneve të varësisë,për disa mallra e shërbime”,Ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik,i ndryshuar,VKM nr.914 dt.29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të prokurimit

Publik”,neni 60.Mbështetur në Udhëzimin nr.30 dt.27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,pika 37,39,47,54.

Në përfundim të auditimit të dosjes së tenderit nga grupi i auditimit u konstatua kjo gjetje:

- Sektori i Financës në momentin e pagesës,nuk ka llogaritur dhe ndalur vlerën e garancisë së kontratës prej 260.034 lekë, në kundërshtim me nenin 17 të saj. (testi nr.5/8)

U rekomandua që Drejtoria e Ekonomike të përcaktojë përgjegjësit e neglizhencës në llogaritjen dhe ndalesën e vlerës së garancisë së kontratës për procedurën e prokurimit “Blerje materiale pastrimi”,Fondi limit : 2.655.630 lek pa tvsh sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.(Rëndësia/ risk i ulët).

Nga nëpunësi përgjegjës me shkresën nr.1014/4 prot, datë 09.04.2019 u kthye observacion lidhur me këtë gjetje duke theksuar se:

“..... operatorit ekonomik i është mbajtur garancia e kontratës në masën 10% për periudhën 12.05.2016 deri në datë 12.05.2017 (formulari i sigurimit të kontratës),periudhë më e madhe se vlefshmëria e kontratës..... Nuk ka arsye pse operatorit ekonomik ti mbahet garancia e kontratës në pagesë.

Lidhur me këtë observacion grupi i auditimit sqaron se: Formulari i sigurimit të kontratës dhe garancia e kontratës janë dy opsione ekonomike të ndara nga njëra tjetra. Në vlerësimin e rregullshmërisë së kryerjes së procedurave të tenderimit jemi bazuar në nenin 17 të kontratës së lidhur me operatorin ekonomik fitues dhe që përcakton qartë procedurat e mbajtjes së garancisë së kontratës.

Koment: Grupi i auditimit nuk e ndryshon opinionin e tij lidhur me këtë gjetje, pasi konstatimet qëndrojnë dhe observacioni është vetëm i natyrës justifikuese, kjo gjetje do të pasqyrohet dhe në Raportin Final të Angazhimit

3.Në tenderin : “Blerje Kanceleri”,Fondi limit :41.624.357,40 lek pa tvsh (tender i përqëndruar), fondi i fituar 2.356.021,70 lekë pa tvsh,firma fituese “INFOSOFT” shpk.

Procedurat e zhvillimit të tenderit janë kryer nga Ministria e Punëve të Brendshme në bazë të VKM nr.28 dt.14.01.2015 “Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik,në emër dhe për llogari të Kryeministrisë,Ministrive dhe institucioneve të varësisë,për disa mallra e shërbime”,Ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik,i ndryshuar,VKM nr.914 dt.29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të prokurimit Publik”,neni 60. Mbështetur në Udhëzimin nr.30 dt.27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,pika 37,39,47,54. Komisioni i marrjes në dorëzim është ngritur me urdhër nr.596/2, datë 23.06.2016

Nga ana e shitësit në këtë rast INFOSOFT OFFICE shpk është bërë lëvrimi i mallit në dy furnizime pjesore sipas faturave nr. 119859534, datë 18.07.2016 në vlerë 1,410,647 leke me tvsh është marrë në dorëzim nga komisioni më proces verbal nr.596/4, datë 18.07.2018 dhe është bërë hyrje në magazinë sipas fletë hyrjes nr.43, 43/1, 43/2,/43/4 datë 18.07.2016 në vlerën 1,410,647 lekë, furnizimi i dytë është kryer sipas faturës nr. 119859997, datë 26.07.2016 në vlerën 1,416,578 lekë, është marrë në dorëzim nga komisioni sipas proces verbalit nr.596/5 prot, datë 25.10.2016 në vlerën 1,416,579 lekë dhe është bërë hyrje në magazinë sipas fletë hyrjes nr.49, 49/1,49/2, 49/3, datë 25.10. 2016. Sipas kontratës së lidhur me nr.596/1, datë 22.06.2016, neni 6 i saj –Afati i lëvrimin dhe marrjes në dorëzim, pika 6.2, afati lëvrimin të mallit është 35 ditë nga data e nënshkrimit të Kontratës. Në nenin 16 të kontratës është përcaktuar se –Kohëzgjatja e kontratës është 35 ditë. Bazuar në nenin 19 të kontratës “hyrja në fuqi e kontratës” pika19.2 Sektori i Shërbimeve të Përgjithëshme është ngarkuar për ndjekjen dhe realizimin e kësaj kontrate deri në përfundimin e saj duke e ngarkuar atë me përgjegjësi për mosrealizimin në kohë të kontratës.

Në përfundim të auditimit të kësaj dosje tenderi nga grupi i auditimit u konstatuan këto gjetje:

- Afati i lëvrimin të mallit sipas nenit 6 të kontratës është tejkaluar me rreth 93 ditë, në kundërshtim me kushtet e kontratës, neni 6.**
- Sektori i Financës ka kryer likuidimin e faturës pa llogaritur dhe mbajtur penalitet sipas nenit 11 “sanksionet”. (vlera e penalitetit e llogaritur për 93 ditë vonesë është: 93 ditë x 1.416.579 x 4/1000 = 526.967 lekë). (testi nr.5/12)**

U rekomandua që:

- Drejtoria Ekonomike të përcaktojë përgjegjësit për mosllogaritjen dhe mbajtjen e penalitetit për ditët e vonesës në lëvrimin e mallit për procedurën e prokurimit “Blerje Kanceleri” Fondi limit : 2.356.021,70 lekë pa tvsh, përpara likuidimit total të faturës.*
- Autoriteti Kontraktor dhe Drejtoria e Ekonomike ti kërkojë firmës fituese, penalitetin e llogaritur për ditët e vonesës në lëvrimin e mallit, sipas kushteve të kontratës së lidhur mes Operatorit Ekonomik “Infosoft” shpk dhe ADISA me nr.596/1, datë 22.06.2016, neni 6 “Afati i lëvrimin dhe marrjes në dorëzim”.*
- Të marrë masa ndajë personave përgjegjës (Sektori i Shërbimeve Mbështetëse) për neglizhencë në ndjekjen dhe realizimin në kohë të kontratës. (Rëndësia/Risk i lartë)*

Nga nëpunësi përgjegjës me shkresën nr 1014/4 prot, datë 09.04.2019 u kthye observacion lidhur me këtë gjetje duke theksuar se:

.....sjellim në vëmendje se vonesa në dorëzim ka qenë vetëm për një artikull “Hapëse vrimash 100 fletë, sasia 10 copë, çmimi për njësi 1.872 lekë dhe jo e gjithë ose pjesërisht kontrata.....

Është konsideruar si vlerë jo e konsiderueshme për ti mbajtur penalitet operatorit ekonomik për sa kohë në thelb këtij operatori i është krijuar dëm ekonomik (mungesë likujditeti) duke e shtyrë pagesën gati 4 muaj nga faturimi.....”

Lidhur me këtë observacion grupi i auditimit thekson se : nga Sektori i Financës për pagesën e kryer nuk janë marrë për bazë kërkesat e kontratës së lidhur me operatorin ekonomik dhe konkretisht neni 11 “Sanksionet” si dhe të Udhëzimit MF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. pika 37,39,40,45,46,48,49,50.

Koment: Grupi i auditimit nuk e ndryshon opinionin e tij lidhur me këtë gjetje, pasi konstatimet qëndrojnë dhe observacioni është vetëm i natyrës justifikuese, kjo gjetje do të pasqyrohet dhe në Raportin Final të Angazhimit.

4.Në tenderin:“Rikonstruksioni i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike, Gjirokastër-ADISA”, Fondi limit: 50.555.093 lek pa tvsh, Fondi i fituar : 42.184.424,46 lek pa tvsh, Firma fituese:BOE “Leon Konstruksion” shpk & “Ergi” shpk & “Hastoçi”shpk.

Me urdhër nr.1188/2 dt.26.10.2016 të titullarit është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave me kryetar I.Gjika,ndërsa me urdhërin nr.1188/8 dt.16.12.2016 është bërë zëvendësimi i kryetarit të KVO z.I.Gjika me zj.Ariela Shtëmbari me arësyetim të konfliktit të interesit por pa dhënë shkakun e plotësuar dhe procedurat sipas ligjeve në fuqi. Urdhër i brendshëm nr.1188/14 dt.20.11.2017 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të përkohshëm të objektit Gjirokastër”,anëtar Ariela Shtëmbari ku njëkohësisht ka qene dhe kryetare ne KVO,në kundërshtim me Neni 58 – Komisioni i vlerësimit të ofertave-.....Kryetari i komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit.....

Gjetje nga auditimi

Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit “Rikonstruksioni i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike, Gjirokastër- ADISA” Fondi limit: 50.555.093 lek pa tvsh, në të dy rastet (emërimit dhe zëvendësimit) është përcaktuar në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar neni 58 i tij “komisioni i vlerësimit të ofertave” pasi Kryetari i KVO duhet të jetë Zyrtarë i Lartë Drejtues i Autoritetit Kontraktor, po kështu në rastin e ndryshimit të Kryetarit të komisionit nuk janë respektuar procedurat ligjore. (Testi nr.5/14)

U rekomandua që titullari i institucionit për periudhën në vazhdim në urdhërat e nxjerrë për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) për procedurat e tenderit të zhvilluara në ADISA, të përcaktojë si Kryetarë të KVO njërin nga Zyrtarët e Lartë Drejtues në ADISA (Drejtor Drejtorie) në përputhje me kriteret ligjore. (rëndësia/risk i lartë).

Nëpunësi përgjegjës me shkresën nr.1014/4 prot, datë 09.04.2019 është shprehur dakort me gjetjen dhe rekomandimin e lënë kështu që gjetja do të pasqyrohet dhe në Raportin Final të Angazhimit.

5.Në tenderin: Rikonstruksion i Qendrës për Ofrimin e Shërbimeve Publike të Integruara Krujë, Fondi limit: 18.244.093,33 lekë pa tvsh, Fondi i fituar: 15.953.641,80 lekë pa tvsh së bashku me shtesën 2.995.930,52 lekë pa tvsh. Firma fituese: BUILDING CONSTRUCTION” sh.p.k

Me urdhërin nr.1053/2, dt.29.09.2016 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit te ofertave”, është caktuar z.Elton Kallabaku si Kryetar me detyrë inxhinier pranë ARRSH (I jashtëm). Më këtë punonjës është lidhur kontrata e punës me nr.1166 dt.18.10.2016 “Kontrate me kohë pune të pjesëshme”, në mbështetje të Kreu VII, të VKM Nr 914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, paragrafi i dytë në të cilin theksohet se.....”Në rastin e mungesës së personelit, autoriteti kontraktor mund të punësojë me kontratë ekspert të jashtëm, si anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave...”.

Sipas kontratës nr.1053/6 dt.24.11.2016, punimet do të përfundojnë me dt.30.12.2016 (rreth 1 muaj).

Me shkresën nr.1244, datë 27.12.2016 “Njoftim për përfundimin e punimeve” firma fituese Building Construction” Sh.P.K ka njoftuar Autoritetin Kontraktor për Përfundimin e punimeve sipas kontratës nr. 1053/6 datë 24.11.2016. Nga ADISA nuk është ngritur komision për marrjen në dorëzim të punimeve.

Me shkresën nr.1300/5 dt 30.11.2016 “Raportim për mbledhje kantieri” të zhvilluar midis Përfaqësuesve të ADISA dhe Firmës së ndërtimit “Building Construction” Sh.P.K, është diskutuar mbi ecurinë e punimeve, gjatë këtij takimi nga firma e ndërtimit është paraqitur nevoja e punimeve shtesë në objekt. Në përfundim të takimit përfaqësuesit e të dy palëve kanë dalë me konkluzionin se ka nevojë për punime shtesë për realizimin e projektit, këto punime janë llogaritur në vlerën prej 2.995.930,52 leke pa tvsh.

Përfaqësuesit e ADISA kanë hartuar një memo me nr.285, datë 15.03.2017 ku kanë kërkuar realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Shtesë punimesh për rikonstruksionin e godinës ADISA Krujë”.

Likujduar me U.SH nr.110 dt.05.06.2017 shtese kontrate (3.595.116,62 lek – 179.755,83 lek), likujduar në vlerën prej 3.415.360,79 lekë. Kontrata nr.285/5 dt.17.03.2017, neni 25 Sigurimi i

kontratës është në vlerë 395.511.62 leke, mbajtur siguracioni i kontratës (5 %) në vlerën 179.755.83 lekë.

Në përfundim të auditimit të dosjes së tenderit nga grupi i auditimit u konstatuan këto gjetje:

- **Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për procedurën e prokurimit “Rikonstruksion i Qendrës për Ofrimin e Shërbimeve Publike të Integruara Krujë” Fondi limit: 18.244.093,33 lekë pa tvsh, është caktuar një punonjës jashtë ADISA-s i marrë me kontratë të përkohshme, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, paragrafi i dytë (është lënë rekomandim).**

- **Nuk ka proces -verbal nga kontraktuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve se kur kanë filluar punimet shtesë në kundërshtim me kushtet e kontratës neni 14 -Ekzekutimi i punimeve-, pika 14.2. (testi nr.5/15)**

U rekomandua që për procedurën e prokurimit “Rikonstruksion i Qendres për Ofrimin e Shërbimeve Publike të Integruara Krujë” Fondi limit: 18.244.093,33 leke pa tvsh Drejtoria Ekonomike të nxjerrë përgjegjësit për mosplotësimin e dosjes së tenderit, për periudhën në vazhdim të marrë masa që dosja e tenderit të plotësohet me të gjithë dokumentacionin sipas kritereve ligjore.(rëndësia risk i mesëm).

Nëpunësi përgjegjës me shkresën nr.1014/4 prot, datë 09.04.2019 është shprehur dakort me gjetjen dhe rekomandimin e lënë kështu që gjetja do të pasqyrohet dhe në Raportin Final të Angazhimit.

6.Në tenderin: “Shërbimi i Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike Zyra Pritëse Tiranë dhe godina ADISA” Fondi limit: 3,907,070 lekë pa tvsh, Fondi i fituar: 3,438,940 leke pa tvsh, Firma fituese: “Myrto Security”.

Sipas urdhërit nr.51/5 dt.06.02.2017 “Per ngritjen e KVO” janë caktuar E.Kola kryetar, I.Çelo dhe F.Behari anëtar.Me urdherin nr.51/9 dt.27.02.2017 është kryer një ndryshim në KVO, largohet E.Kola dhe zëvendësohet me O.Memushin ne cilësinë e kryetarit të KVO për procedurat e tenderimit me objekt “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve dhe godinave të ADISA për vitin 2017”, ndryshimi është kryer në shkelje të VKM nr.914 dt.29.12.2014 i ndryshuar, neni 58 – Komisioni i vlerësimit të ofertave-....

Në përfundim të auditimit të dosjes së tenderit nga grupi i auditimit u konstatuan këto gjetje:

- **Zëvendësimi i Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në tenderin :Shërbimi i ruajtjes dhe Sigurisë Fizike Zyra Pritëse Tiranë dhe godina ADISA”, Fondi limit: 3,907,070 lekë pa tvsh, është kryer pa dhënë asnjë arsye.**

- **Emërimi i kryetarit të ri të KVO është bërë në kundërshtim me kriteret ligjore, pasi punonjësi i emëruar si kryetarë është i punësuar si specialist dhe jo Drejtues i Lartë i**

Autoritetit Kontraktor në kundërshtim me VKM nr.914 dt.29.12.2014 i ndryshuar, nenit 58 – Komisioni i vlerësimit të ofertave. (është lënë si rekomandim)((testi nr.5/17).

Nëpunësi përgjegjës me shkresën nr.1014/4 prot, datë 09.04.2019 është shprehur dakort me gjetjen dhe rekomandimin e lënë kështu që gjetja do të pasqyrohet dhe në Raportin Final të Angazhimit.

- Prokurimit Publike me vlerë nën 800,000 lekë (Blerjet me Vlerë të Vogël).

Bazuar në kërkesat buxhetore sipas Drejtorive dhe Zyrave pritëse ADISA nëpër rrethe është hartuar regjistri i parashikimit të prokurimeve me vlerë nën 800,000 lekë.

Për periudhën e audituar janë planifikuar gjithësej 37 proçedura prokurimi, janë kryer gjithsej 36 proçedura, kështu për vitin 2017 janë parashikuar të kryhen 31 proçedura për Blerjet me Vlera të Vogëla në vlerë 6,463,788 lekë janë realizuar gjatë këtij viti 31 proçedura në vlerë 3,879,670 lekë, për vitin 2018 janë planifikuar gjithësej 12 procedura prokurime në vlerë 1,504,052 lekë, për periudhën Janar –Prill 2018 janë planifikuar 6 procedura ne vlerë 507,499 leke janë realizuar për këtë periudhë gjithësej 5 proçedura në vlerë 819,809 lekë.

Nga auditimi i Prokurimeve të kryera për Blerjet me Vlera me të Vogla se 800,000 lekë (me zgjedhje) rezultoi se janë respektuar proçedurat ligjore sipas Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe VKM nr 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore. U audituan me zgjedhje 10 proçedura prokurimi në të cilat nuk u konstatuan parregullsi. Sistemi i prokurimit për blerjet me vlera të vogëla ka funksionuar mirë. (Sistemi paraqitet me risk të ulët).(testi nr.6 dhe nr.7)

Sektori i Administrimit të të Ardhurave dhe Menaxhimit të Projekteve

Lidhur me veprimtarinë e ushtruar për periudhën e audituar ky sektor ka hartuar planin e punës për vitin 2017, 2018, ka hartuar harten e proçeseve të punës, regjistrin e rriskut dhe Gjurmët e auditimit të cilat i ka miratuar te Drejtori i Drejtorisë.

Por në vetvete ky sektor që kur është krijuar nuk ka ushtruar asnjë funksion të përcaktuar sipas Rregullores së Brendëshme të Funksionimit të ADISA. Punonjësit e këtij sektori kanë kryer detyra të ndryshme të ngarkuara në funksion të drejtorive dhe sektorëve të tjerë në ADISA. (Me ndryshimin e Strukturës së ADISA për vitin 2019 ky sektor nuk është pjesë e strukturës së re).

Konkluzion

Sistemi i përputhshmërisë ka funksionuar me disa mangësi në kryerjen e proçedurave të prokurimit. Funksionimi i sistemit paraqitet me risk të mesëm.

Në përfundim të auditimit për përmirësimin e punës në të ardhmen rekomandojmë:

V. PLAN VEPRIMI PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE.

(Rekomandime sipas nivelit të drejtimit)

Rekomandim nr.1

Titullari i institucionit të nxjerrë urdhër të brendshëm dhe të marrë masa për ndjekjen e zbatimit të rekomandimit të lënë në auditimin e kaluar dhe që nuk ka gjetur zbatim. Në rast të mosarkëtimit të shumës prej 7.200 lekë, paguar më tepër subjektit fitues Denis Mana sipas urdhër prokurimit nr.66 dt.30.11.2016, të fillojë zhdëmtimi nga punonjësit përgjegjës. (Rëndësia/Risk i mesëm).

Brenda muajit Maj

Rekomandim nr.2

- Titullari i institucionit të nxjerrë urdhër të brendshëm dhe të kërkojë zbatimin e tij që Drejtoria e Administrimit të Brendshëm për të gjitha materialet që nxirren nga magazina ADISA, të përcaktojë një normativë shpërndarje, kështu për materialet e konsumit që përdoren në Zyrat qendrore të ADISA dhe Zyrat Pritëse nëpër rrethe të hartohet një kartelë limit shpërndarje, për materialet që përdoren për promovimin e ADISA në aktivitete të ndryshme dhe shpërndarjen e tyre në Zyrat Vendore /Rajonale si dhe materialet që përdoren për riparime të ndryshme, nga personi përgjegjës që tërheq mallin nga magazina të hartohet një MEMO informuese/ose preventiv shpenzimesh /ose proces verbal, duke përcaktuar aktivitetin ose Zyrën Pritëse ADISA në të cilin janë përdorur dhe shpërndarë këto materiale duke i evidentuar në sasi, e njëjta mënyrë do përdoret dhe nga mirëmbajtësi i godinave për materialet e përdorura gjatë riparimeve të ndryshme, këto dokumenta ti bashkëlidhen Fletë daljeve të magazinës të cilat regjistrohen në kontabilitet nga Sektori i Financës.

- Drejtoria Ekonomike, për periudhën në vazhdim të ushtrojë kontrolle të vazhdueshme mbi dokumentacionin shoqërues që justifikojnë hyrje- daljet nga magazina dhe të kërkojë plotësimin e tyre përpara regjistrimit në kontabilitet të këtyre dokumentave.(Rëndësia/Risk i lartë)

Menjëherë dhe vazhdimisht

Rekomandim nr.3

Nëpunësi Autorizues në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të marrë masa që pas përfundimit të inventarizimit të shqyrtojë rezultatet e dala nga inventarizimi, të nxjerrë urdhër për ndjekje nga Nëpunësi Zbatues në lidhje me kompensimet dhe sistemimin e diferencave nëse ka, gjithashtu Nëpunësi Autorizues të nxjerrë urdhër për ngritjen e grupeve të punë për vlerësimin e aktiveve të propozuara për jashtë përdorimit dhe asgjësimin e tyre nga komisioni i ngritur për këtë procedurë, konformë me Udhëzimin nr.30 dt.27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar.(Rëndësia/Risk i mesëm)

Për periudhën në vazhdim

Rekomandim nr.4

Titullari i institucionit ti drejtohet me një shkresë zyrtare Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrisë për miratimin e Autorizimit për dërgimin me shërbim të punonjësve të ADISA jashtë qendrës së punës, brenda vendi, në respektim të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, i ndryshuar, Kreu V “Dërgimi me shërbim i punonjësit” pika 2, gërma ii, bazuar dhe në faktin që punonjësit e ADISA janë të detyruar të kryejnë lëvizje të shpeshta për arsye të natyrës së punës dhe objektivave që ka ADISA si institucion për ngritjen e Zyrave të Shërbimit në të gjithë Shqipërinë. (Rëndësia/Risk i lartë).

Menjëherë

Rekomandim nr.5

Autoriteti Kontraktor në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të përcaktojnë përgjegjësit e realizimit të procedurës së prokurimit “Shtesë kontrate Blerje Tонера për nevoja të fillim vitit 2017” me fond limit 494.273,52 lek pa tvsh, jashtë afateve të përcaktuara në kriteret ligjore. (Rëndësia/Risk i mesëm)

Brenda muajit Maj

Rekomandim nr.6

Drejtoria e Ekonomike të përcaktojë përgjegjësit e neglizhencës në llogaritjen dhe ndalesën e vlerës së garancisë së kontratës për procedurën e prokurimit “Blerje materiale pastrimi”, Fondi limit : 2.655.630 lek pa tvsh sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. (Rëndësia/ risk i ulët)

Brenda muajit Maj

Rekomandim nr.7

- Drejtoria Ekonomike të përcaktojë përgjegjësit për mosllogaritjen dhe mbajtjen e penalitetit për ditët e vonesës në lëvrimitin e mallit për procedurën e prokurimit “Blerje Kanceleri” Fondi limit : 2.356.021,70 lekë pa tvsh, përpara likuidimit total të faturës.

- Autoriteti Kontraktor dhe Drejtoria e Ekonomike të nxjerrë urdhër dhe ti kërkojë firmës fituese, penalitetin për ditët e vonesës në lëvrimitin e mallit, sipas kushteve të kontratës së lidhur mes Operatorit Ekonomik “Infosoft” shpk dhe ADISA me nr.596/1, datë 22.06.2016, neni 6 “Afati i lëvrimit dhe marrjes në dorëzim”.

- Titullari i institucionit të marrë masa ndajë personave përgjegjës (Sektori i Shërbimeve Mbështetëse) për neglizhencë në ndjekjen dhe realizimin në kohë të kontratës. (Rëndësia/Risk i lartë)

Brenda muajit Maj

Rekomandim nr.8

Titullari i institucionit për periudhën në vazhdim në urdhërat e nxjerrë për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) për procedurat e tenderit të zhvilluara në ADISA, të përcaktojë si Kryetarë të KVO njërin nga Zyrtarët e Lartë Drejtues në ADISA (Drejtor Drejtorie) në përputhje me kriteret ligjore. (Rëndësia/Risk i lartë)

Vazhdimisht

Rekomandim nr.9

Për procedurën e prokurimit “Rikonstruksion i Qendrës për Ofrimin e Shërbimeve Publike të Integruara Krujë” Fondi limit: 18.244.093,33 leke pa tvsh Drejtoria Ekonomike të nxjerrë përgjegjësit për mosplotësimin e dosjes së tenderit, për periudhën në vazhdim të marrë masa që dosja e tenderit të plotësohet me të gjithë dokumentacionin sipas kriterëve ligjore.(rëndësia risk i mesëm).

Brenda muajit Maj

Raporti Final i Angazhimit mbahet në 3 (tre) kopje origjinale, ku një kopje i dërgohet Subjektit të Audituar, një kopje lihet në Protokoll dhe një kopje mbahet nga Auditi i Brendshëm.

Grupi i Auditimit

Thoma PAPADHIMITRI

Shkurte HALILI